REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRSANSPORTA
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 01
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 7412
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: 02 faqe
Data / Datum / Date: 11.07.19
PRISHTINË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
Njësia Org. / Org. Jedinica: KM - MIT
2+ fq
Nr. I Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 483/19
Data / Datum / Date: 11.07.19
PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Ministria Infrastrukturës dhe Trasnportit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*
*Ministry of Infrastructure and Transportation*

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ 06/2016 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërurban të Udhëtarëve me Autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr.5517 të dt.23.05.2019, nxjerr këtë:

## VENDIM

**Refuzohen** ankesat nr. prot. 4354 të dt. 24.04.2019 dhe 4852, 4853 të dt. 08.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.SH. "Berisha Impex" nga Peja, ndaj vendimit nr.4149 të dt.19.04.2019 që ndërlidhet me vendimin nr.4150 të dt.19.04.2019 për aprovim për pjesërishëm të kërkesës nr.2099 përkatësisht aprovimi i marrjes të nisjes në relacionin Istog - Klinë - Prishtinë për nisjen në ora 05:30 me kthim në ora 07:30, ndaj vendimit nr. 4144 të dt. 19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Pejë – Gurrakoc - Istog për nisjen në ora 14:15 me kthim në ora 15:15 dhe ndaj vendimit nr.4143 të dt. 19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Pejë – Banjë - Vrellë-Istog për nisjen në ora 06:30 me kthim në ora 08:00.

## Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës. 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesave nr. prot.4354 të dt. 24.04.2019 dhe 4852, 4853 të dt. 08.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues N.T.SH. "Berisha Impex" nga Peja, ndaj vendimit nr. 4149 të dt. 19.04.2019 që ndërlidhet me vendimin nr. 4150 të dt. 19.04.2019 për aprovim për pjesërishëm të kërkesës nr. 2099 përkatësisht aprovimi i marrjes të nisjes në relacionin Istog – Klinë - Prishtinë për nisjen në ora 05:30 me kthim në ora 07:30, vendimit nr.4144 të dt. 19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Pejë – Gurrakoc - Istog për nisjen në ora 14:15 me kthim në ora 15:15 dhe vendimit nr.4143 të dt. 19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Pejë – Banjë – Vfrellë - Istog për nisjen në ora 06:30 me kthim në ora 08:00 dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbaleve të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18

të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, ka konstatuar se në bazë të procesverbaleve nr. 2099, 2100 dhe 2129 të dt.11.03.2019 të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 vlerësojmë se komisioni ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit nëse ndarja e dosjeve në aplikacione ka qenë siç përshkruhet në procesverbale kështu që operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (3) të shpalljes publike nr.1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.7 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosjet e aplikimit ka prezantuar nga 3 (tre) autobus të certifikuar për secilin aplikacion ndërsa sipas evidencës në DTT të konstatuar nga komisioni sipas vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit i njëjti posedon 13 (trembëdhjetë) rende të udhëtimit në transportin ndër urban dhe 1 ( një) rendë të udhëtimit të aprovuar sipas vendimit 4150 të dt.19.04.2019 që në total janë 14 ( katërmbëdhjetë) rende të udhëtimit në transportin ndër urban. Gjithashtu edhe numri i përgjithshëm i autobusëve të prezantuar në dosje të aplikimit me numrin e nisjeve në transportin ndër urban, përfshirë edhe nisjen e fituar në këtë shpallje, 14 ( katërmbëdhjetë) rende të udhëtimit në transportin ndër urban, komisioni vlerëson se vlerësimi i komisionit të emëruar me vendimin nr.prot.2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, është i drejtë pasi që ky raport mes nisjeve dhe numrit të autobusëve të prezentuar krijon situatë të funksionimit të kufizuar (pamundësi për operim të rregullt) të operatorit në fjalë në të gjitha linjat dhe si i tillë kapacitetet e tij teknike kufizojnë mundësin e marrjes të vijave tjera.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:**
Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroi pari në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**I dërgohet:**

- -Kabinetit të Ministrit;
- -Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- -Parashtruesit të kërkesës;
- -Departamentit të Transportit Tokësor;
- -Zyrës së Arkivit të MI –së.

Ministri:
Pal LEKAJ



Objekti "Gërmia", Rr.Nëna Terezë-10.000 Prishtinë, Kosovë
www.mi-ks.net